



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave

WITH FUNDING FROM



AUSTRIAN
DEVELOPMENT
COOPERATION

Buxhetimi për Përmirësimin e Barazisë Gjinore në Programet për Diasporën



© 2017 Rrjeti i Grave të Kosovës

ISBN-978-9951-737-21-0

Ky publikim u mundësua me përkrahjen bujare të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA). Opinionet e shprehura në këtë publikim janë të autoreve dhe jo domosdoshmërisht të qeverisë Austriake apo ADA-s.

Shtypur me materiale ekologjike.

Buxhetimi për Përmirësimin e Barazisë Gjinore në Programet për Diasporën

Nga Nerina Guri dhe Nicole Farnsworth për Rrjetin e Grave të Kosovës

Pasqyra e lëndës

Akronimet	2
Mirënjohje.....	3
Përmbledhje ekzekutive.....	4
Hyrje	5
Rreth diasporës	5
Përgjegjësitë e Ministrisë së Diasporës	6
Buxheti dhe shpenzimet e përgjithshme	7
Zyra e Ministrit.....	11
Administrata Qendrore	13
Divizioni i Prokurimit Publik	15
Divizioni i Komunikimit me Publikun.....	16
Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme.....	16
Departamenti Ligjor.....	16
Departamenti për Qendrat Kulturore në Diasporë.....	19
Departamenti për Ruajtjen dhe Kultivimin e Arsimit dhe Kulturës në Diasporë.....	20
Departamenti i Hulumtimeve dhe i Përkrahjes së Investimeve të Diasporës.....	23
Shtojca 1. Projektet e subvencionuara nga Ministria e Diasporës	25
Shtojca 2. Buxheti dhe shpenzimet e përgjithshme sipas departamentit ose organit	33
Shtojca 3. Tabelat e punonjësve dhe të pjesëmarrjes në trajnime për periudhën 2015-2017	34
Bibliografia	38

Akronimet

ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BPGJ	Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor
D4D	Instituti “Demokraci për Zhvillim”
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KMDLNJ	Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MD	Ministria e Diasporës
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
RrBDSH	Rrjeti i Bizneseve të Diasporës Shqiptare
RrGK	Rrjeti i Grave të Kosovës
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar
ZBGJ	Zyrtari për Barazi Gjinore

Mirënjohje

Kjo analizë u bë e mundur falë përkushtimit të Ministrisë së Diasporës (MD) në drejtim të zbatimit të dispozitave të Ligjit të ri për Barazi Gjinore, të cilat kanë të bëjnë me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor (BPGJ). Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) falënderon zyrtarët e MD-së për bashkëpunimin e tyre, pra: ministrin e Diasporës, z. Valon Murati, sekretarin e përgjithshëm, z. Osman Shahini, drejtorin e Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, z. Ragip Zejnullahu, drejtorin e Divizionit të Buxhetit dhe Financave, z. Hamdi Bërbatovci, zyrtarin për të Drejtat e Njeriut dhe Barazinë Gjinore, z. Elmas Sufta, dhe të gjithë udhëheqësit e departamenteve dhe divizioneve të cilët kontribuan duke ofruar të dhëna të nevojshme.

Autoret falënderojnë drejtoreshën ekzekutive të RrGK-së, Igballe Rogova, menaxheren e financave, Besa Shehu, dhe menaxheren e projekteve, Zana Rudi, për përkrahjen e tyre të vazhdueshme. Miranda Avdullahu ndihmoi me realizimin e hulumtimit dhe të analizave si dhe me aktivitete të koordinimit. Vanessa Robinson-Conlon kontribuoi duke redaktuar këtë raport. Publikimi u rishikua nga kolegja Donjeta Morina.

Përmbledhje ekzekutive

Gratë, burrat, vajzat dhe djemtë shpeshherë kanë nevoja dhe prioritete të ndryshme. Politikat dhe programet për diasporën duhet t'i marrin parasysh këto dallime. Buxheti i përgjegjshëm gjinor (BPGJ) përfshin integrimin e çështjeve gjinore në të gjitha fazat e planifikimit, ekzekutimit, monitorimit dhe vlerësimit të buxheteve shtetërore. Në Kosovë, të gjitha organizatat buxhetore detyrohen me ligj që të kryejnë një BPGJ, në drejtim të çuarjes përpara të barazisë gjinore dhe përmbushjes më të mirë të nevojave të qytetarëve të ndryshëm. Kryerja e analizës gjinore është hapi i parë thelbësor për sigurimin e informatave për BPGJ-në. Për këtë arsye, Ministria e Diasporës (MD) dhe Rjeti i Grave të Kosovës (RrGK) kanë bashkëpunuar ngushtë për të kryer këtë analizë gjinore, në funksion të identifikimit të objektivave dhe veprimtarive specifike për çuarjen më tej të barazisë gjinore në punën e Ministrisë. Përmes rekomandimeve që dolën nga kjo analizë synohet të ofrohen informata jetike për Buxhetin e MD-së për vitin 2018, si dhe për Kornizat Afatmesme të Shpenzimeve (KASH-et). Më poshtështrihen disa nga gjetjet dhe rekomandimet kryesore:

- Disa departamente dhe organe të MD-së nuk kanë të dhëna të ndara sipas gjinisë apo sisteme për mirëmbajtjen dhe përdorimin e tyre për planifikimin buxhetor. Ministria duhet të sigurojë që punonjësit të mbledhin, mirëmbajnë dhe përdorin të dhëna të ndara sipas gjinisë lidhur me personat e synuar, personat e konsultuar dhe ata që përfitojnë nga programet e MD-së, në funksion të përmirësimit të informatave që shërbejnë për planifikimin e shpenzimeve të ardhshme.
- Krahas këtij raporti, Ministria nuk ka kryer ndonjë analizë të njohur gjinore për të mbledhur të dhëna për hartimin ose analizimin e ligjeve, politikave dhe strategjive ekzistuese që kanë të bëjnë me diasporën. Ministria duhet të kryejë analiza gjinore për të siguruar të dhëna që do të shërbejnë për hartimin e ligjeve, politikave, strategjive, programeve dhe planveprimeve, duke analizuar mënyrën se si këto ndikojnë në mënyrë të ndryshme te burrat dhe gratë. Ministria duhet të sigurojë pjesëmarrjen e zyrtares për barazi gjinore (ZBGj) në grupet e punës.
- Deri në maj të 2017-ës, gratë përbënin vetëm 23% të të gjithë përfituesve të subvencioneve dhe transfereve dhe pranonin vetëm 20% të shpenzimeve (më pak se 22,000 euro nga 110,000 euro) MD-ja duhet të marrë masa pozitive për rritjen e përqindjes së subvencioneve dhe granteve prej të cilave përfitojnë gratë.
- Në proceset e prokurimit nuk janë përfshirë veprimet pozitive drejt çuarjes më tutje të barazisë gjinore, sikurse parashihet në Ligjin e ndryshuar për Prokurimin Publik. Divizioni i Prokurimit Publik mund ta rrisë përfshirjen e objektivave sociale që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, në kuadrin e kontratave, duke i detyruar kështu kontraktorët që të zbatojnë masa të projektuara për promovimin e barazisë gjinore gjatë zbatimit të kontratave të tyre.
- Më pak burra se gra kanë përfituar nga mundësia që studentët nga diaspora të kryejnë punë praktike në ministri të ndryshme. Gratë përbëjnë 35% të të gjithë praktikantëve gjatë periudhës 2015-2017. Departamenti për Mbrojtjen dhe Kultivimin e Edukimit dhe Kulturës në Diasporë mund të përdorë masa afirmative për të nxitur më shumë burra që të marrin pjesë në programet e punëve praktike.
- Numri i grave që kanë marrë pjesë në trajnimet e zhvilluara gjatë vitit 2015 dhe marsit të vitit 2017-ës është më i madh (60%) sesa ai i burrave (40%). Përveç nëse përmes kësaj mase afirmative synohet ngritja në karrierë e grave, MD-ja duhet të ketë parasysh sigurimin e një pjesëmarrjeje më të ekuilibruar të grave dhe burrave në trajnime.
- Në prill të vitit 2017, 37% e punonjësve të MD-së ishin gra dhe 63% burra. Burrat pranonin 70% të shpenzimeve të pagave dhe mëditjeve në vitin 2016. Numri i burrave që kanë punuar vazhdimisht në nivele më të paguara dhe vendimmarrjeje ishte më i madh (81%) sesa ai i grave (19%). MD-ja duhet të përdorë masa afirmative për të punësuar dhe ngritur në detyrë më shumë gra të kualifikuara, duke kontribuar kështu drejt shpenzimeve më të ekuilibruara në kategorinë ekonomike të pagave dhe mëditjeve.
- Gratë kanë marrë pjesë në 20% të udhëtimeve zyrtare nga të gjitha udhëtimet zyrtare në vitin 2016. Për rrjedhojë, zyrtaret kanë pranuar vetëm 15% të shpenzimeve për udhëtime zyrtare. MD-ja duhet të sigurojë ekuilibër gjinor në radhët e anëtarëve të personelit që marrin pjesë në udhëtime zyrtare.

Ky raport përfshin objektiva dhe aktivitete specifike për secilin departament të Ministrisë në funksion të zbatimit të barazisë gjinore përmes shpenzimeve të saj të ardhshme.

Hyrje

Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor (BPGJ) është një strategji përmes së cilës perspektiva gjinore futet në çdo cikël planifikimi, zbatimi, monitorimi dhe vlerësimi të buxheteve, shpenzimeve dhe politikave fiskale. Që prej vitit 2015, me Ligjin për Barazi Gjinore, të gjitha institucionet publike në Republikën e Kosovës u kërkohej të zbatojnë BPGJ-në. Në ligj, BPGJ-ja përkufizohet si:

[Z]batimi i integritetit gjinor në procesin buxhetor. Kjo do të thotë vlerësim i buxheteve nga pikëpamja e gjinisë, në rastin kur çështja gjinore është marrë parasysh në të gjitha nivelet e procesit buxhetor, të hyrave dhe shpenzimeve të ristrukturimit me qëllim të promovimit të barazisë së femrave dhe meshkujve.¹

Zbatimi i BPGJ-së mund të kontribuojë në përmirësimin e reagimit për të përmbushur më mirë nevojat e grave dhe burrave me shpenzime shtetërore. Si pjesë të qarkoreve të buxhetit, që prej vitit 2015, Ministria e Financave u ka dhënë institucioneve të Kosovës mostra për facilitimin e analizës gjinore për futjen e të dhënave në BPGJ në Kornizat Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) dhe buxhetet vjetore.

Ministria e Diasporës (MD) është ministria e gjashtë që RrGK-ja ka përkrahur në institucionalizimin e BPGJ-së.² Qëllimi i këtij raporti është të ndihmojë MD-në për të kryer BPGJ-në, nëpërmjet ofrimit të një analize të programimit të saj në të shkuarën dhe në të tashmen. Kryerja e një analize gjinore është hapi i parë thelbësor për të kuptuar çfarëdo lloj pabarazie që mund të ekzistojë, me qëllim që MD-ja të mund të planifikojë më mirë shpenzimet në të ardhmen.

Rreth diasporës

Për të hartuar politika dhe programe që plotësojnë nevojat e diasporës, është e rëndësishme që të kuptohet diaspora. MD-ja ka bërë përpjekje për ta kuptuar më mirë diasporën, kryesisht përmes Regjistrimit të Diasporës, përmes të cilit synohet të regjistrohet pjesa më e madhe e njerëzve që jetojnë në diasporë.

Në qershor të 2017-ës, Ministria publikoi informatat paraprake lidhur me diasporën e Kosovës, mbështetur në Regjistrin e Diasporës.³ Nga personat e regjistruar,⁴ shumica duket se jetojnë në Gjermani (36.8%) dhe Zvicër (29.8%). Të tjerë jetojnë në Itali (4.9%), Suedi (4.6%), Austri (4.3%), Francë (3.8%), Belgjikë (2.5%), Mbretërinë e Bashkuar (2.4%), SHBA (1.97%), Norvegji (1.6%), Slloveni (1.3%), Finlandë (1.1%), Holandë (0.9%), Danimarkë (0.7%), dhe Kanada (0.6%), dhe në vende të tjera (3.2%). Shumica janë shqiptarë (96.7%). Megjithatë, janë regjistruar edhe serbë (0.1%), turq (0.1%), boshnjakë (1.3%), romë (0.3%), ashkalinjë (0.5%), egjiptianë (0.1%), goranë (0.2%) dhe grupet e tjera etnike (0.5%).⁵

Gratë përbëjnë 44.3% të diasporës së regjistruar ndërsa burrat 55.7%. Megjithatë, të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 lënë të kuptohet se diaspora përfshin njëfarë ekuilibri midis grave (49.7%) dhe burrave (50.3%). Nga kjo mund të kuptohet se disa gra që jetojnë në diasporë nuk janë

¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji për Barazi Gjinore, nr. 05/L-020, 2015, marrë nga: <https://mapl.rks-gov.net/getattachment/165dc3a6-5295-4d24-8437-a50f8ed4e237/LIGJI-NR--05-L-020-PER-BARAZI-GJINORE.aspx>, Neni 3.1.17.


² Ministrinë e tjera përfshijnë Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë, dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. RrGK po ashtu ka mbështetur disa komuna.

³ Qeveria e Kosovës, Ministria e Diasporës, "Rezultatet preliminare të Regjistrimit të Diasporës", Prishtinë: 2017, marrë nga: <http://med.rks-gov.net/desk/inc/media/42176B11-3D08-4C9A-A27C-DF38A4706449.pdf>. Rezultatet përfundimtare do të publikohen në vitin 2021.

⁴ Madhësia e mostrës ishte 342,803 deri më 31 dhjetor 2016. Të dhënat janë marrë nga "Rezultatet paraprake të Regjistrimit të Diasporës", Prishtinë: 2017.

⁵ Krahës kësaj, 0.05% parapëlqenin të mos përgjigjeshin ("Rezultatet paraprake të Regjistrimit të Diasporës").

regjistruar në Regjistrin e Diasporës. Pjesa më e madhe e diasporës përbëhet nga njerëz të moshës 15-19 vjeçare (9.52%). Në radhët e burrave, pjesa më e madhe e anëtarëve të diasporës janë të moshës 40-44 vjeçare, ndërsa pjesa më e madhe e grave janë të moshës 15-19 vjeçare. Ndërkohë që burrat kishin prirje të emigrojnë për shkaqe ekonomike (25.6% të diasporës), gratë prireshin të emigronin për “shkaqe familjare” (29.6% të të gjithë respondentëve). Këtu mund të përfshihen bashkimet familjare jashtë vendit, por edhe emigrimi për qëllime martesë.⁶



Burrat priren të kenë nivele më të larta të arsimit sesa gratë, ndërkohë që numri i burrave në diasporë që janë të punësuar është më i lartë sesa ai i grave. Vetëm 0.74% e diasporës së regjistruar kishte nën pronësi biznese të tyre. Nga pronarët e këtyre bizneseve, 94.1% ishin burra dhe 5.9% gra.

Përgjegjësitë e Ministrisë së Diasporës

Organi që i paraprinte dhe që më pas do të bëhej Ministri e Diasporës (MD) u themelua në maj të 2011-ës, fillimisht si Zyra për Çështje Jorezidente, nën përgjegjësinë administrative të Zyrës së Kryeministrit. Më pas u shndërrua në agjenci kombëtare, duke u bërë Ministri në vitin 2011.⁷ Përgjegjësitë dhe prioritetet e saj kryesore janë:

- Të hartojë projekte, politika dhe akte ligjore lidhur me diasporën, ku përfshihen kosovarët që jetojnë jashtë Kosovës;
- Të propozojë dhe administrojë buxhetin e MD-së, duke marrë parasysh kërkesat ligjore të Ministrisë së Financave dhe ato aktuale;
- Të nxisë, kultivojë dhe ruajë identitetin kulturor, arsimor dhe gjuhësor të diasporës;
- Të regjistrojë individë në bashkëpunim me institucione të tjera përkatëse;
- Të hartojë dhe koordinojë programe, studime dhe hulumtime në fushën e diasporës;
- Të shërbejë si urë komunikimi midis institucioneve kombëtare dhe diasporës;
- Të zbatojë politikat kulturore dhe programet arsimore të hartuara nga Ministria e Arsimit dhe që i drejtohen anëtarëve të diasporës;
- Të ofrojë informata dhe mbështetje për anëtarët e diasporës me qëllim që ata të investojnë në Kosovë;

⁶ Ndonëse rrallë, martesat e fëmijëve mund të përfshijë emigrimin, duke i vënë kështu nuset e reja në rrezik izolimi dhe dhunë në familje (shih UNFPA, “Child Marriage in Kosovo (Overview) [Martesa e fëmijëve në Kosovë (vështrim i përgjithshëm)]”, fq. 7, në adresën: <http://eeca.unfpa.org/sites/default/files/pub-pdf/unfpa%20kosovo%20overview.pdf>).

⁷ Intervistë e RrGK-së me udhëheqësin e Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, 27 mars 2017.

- Të hartojë dhe koordinojë qendrat kulturore në Kosovës për diasporën dhe, në bashkëpunim me këto qendra, t'i raportojë qeverisë lidhur me situatën;
- Të hartojë, koordinojë dhe monitorojë zbatimin e strategjisë për diasporën, dhe
- Të koordinojë aktivitetet në bashkëpunim me shoqërinë civile, institucionet komunale dhe shtetërore, organizatat e tjera, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, për të përmirësuar situatën e diasporës.⁸

Për përmbushjen e këtyre përgjegjësiave, *Strategjia e Ministrisë për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018*, përvijon katër objektiva të përgjithshme:

- Promovimi dhe avancimi i të drejtave politike dhe sociale të diasporës;
- Ruajtja e identitetit dhe fuqizimi i lidhjeve me diasporën;
- Integrimi i pjesëtarëve të diasporës në shtetet ku jetojnë; dhe
- Lehtësimi i përfshirjes së diasporës në zhvillimin socio-ekonomik.⁹

Sikurse është raportuar nga media, konsultimet me publikun u realizuan në 23 vende të ndryshme ku banojnë diaspora, me qëllim që të sigurohen të dhëna për *Strategjinë aktuale shtetërore për migrimin dhe planin e veprimit 2013-2018*.¹⁰ Ky plan përmban këto objektiva:

- Parandalimi dhe luftimi i migrimit të parregullt;
- Përmirësimi i menaxhimit të migrimit ligjor dhe qarkullues;
- Transformimi dhe zhvillimi i migracionit në faktor pozitiv ekonomik.¹¹

Megjithatë, kjo strategji nuk i ka bërë çështjet gjinore pjesë integrale të objektivave të veta specifike, masave të planifikuara, aktivitetëve, treguesve ose planit të zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit. Në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore, institucionet publike duhet të integrojnë çështjet gjinore në të gjitha politikat, strategjitë, planveprimet dhe dokumentet. Zyrtarët përgjegjës për hartimin e këtyre dokumenteve të politikave duhet të bashkëpunojnë me ZBGj për të kryer analiza gjinore me qëllim që të sigurohet se politikat marrin parasysh edhe perspektivën gjinore, domethënë mënyrën se si këto politika ndikojnë në mënyra të ndryshme të gratë dhe burrat.

Buxheti dhe shpenzimet e përgjithshme

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme ka ofruar plane për shpenzime dhe buxhet për secilën kategori ekonomike për periudhën nga viti 2015 deri në 2020. Kodi buxhetor i administratës qendrore përfshin shpenzimet e planifikuara dhe reale për të gjitha departamentet, divizionet dhe qendrat kulturore të Ministrisë, me përjashtim të zyrës së ministrit, e cila ka kod të veçantë buxhetor.¹² Në tabelën I paraqitet një përmbledhje e buxhetit dhe shpenzimeve të planifikuara për periudhën 2015-2017.

⁸ MD, "Historiku dhe prioritetet", marrë nga: <http://med.rks-gov.net/Faqe.aspx?id=11&l=0>.

⁹ MD, *Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018*, Prishtinë: korrik 2013, marrë nga: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_per_Diasporen_dhe_plani_i_veprimit_2013-2018.pdf.

¹⁰ KosovaLive360, 15 korrik 2013, marrë nga: <http://www.kosovalive360.com/hartohet-strategjia-per-diasporen-dhe-mergaten.html>.

¹¹ Republika e Kosovës, *Strategjia Shtetërore për Migrim dhe Planin e Veprimit 2013-2018*, Prishtinë: Shtator 2013, marrë nga: https://www.mpb-ks.org/repository/docs/Strategjia_per_Migrim_SHO.pdf.

¹² Korrespondencë e RRGK-së me udhëheqësin e Divizionit të Financave, 1 gusht 2017.

Tabela 1. Buxheti i përgjithshëm dhe shpenzimet e Ministrisë së Diasporës sipas kategorisë ekonomike, 2015-2017												
	2015			2016			2017			2018	2019	2020
	Të buxhetuara	Të shpenzuara	% e buxhetit Përdorur	Të buxhetuara	Të shpenzuara	% e buxhetit të përdorur	Të buxhetuara	Të shpenzuara	% e buxhetit të përdorur (jan-maj)	Të kërkuara	Të parashikuara	Të parashikuara
Punonjës	66	63	95%	66	65	98%	66	65	98%	66	66	66
Buxheti total	1,856,628€	1,531,794€	83%	1,606,803€	1,752,549€	109%	1,626,562€	503,104€	31%	1,631,362€	1,636,161€	1,638,59€
Pagat dhe mëditjet	473,889€	424,884€	90%	458,989€	476,868€	104%	478,748€	153,213€	32%	483,548€	485,966€	488,396€
Mallrat dhe shërbimet	1,227,239€	969,802€	79%	992,314€	1,135,696€	114%	992,314€	264,561€	27%	992,314€	994,695€	944,695€
Shpenzimet komunale	25,500€	9,719€	38%	25,500€	9,985€	39%	25,500€	2,330€	9%	25,500€	25,500€	25,500€
Subvencionet dhe transferet	130,000€	127,389€	98%	130,000€	130,000€	100%	130,000€	83,000€	64%	130,000€	130,000€	130,000€

Pagat dhe mëditjet

Në tabelën 2 ilustron se, deri në prill të vitit 2017, 37% e punonjësve ishin gra, ku shpenzimet për pagat dhe mëditjet për gratë përbënin 30% të shpenzimeve të përgjithshme të kësaj kategorie buxhetore. Gratë ishin më pak të përfaqësuara në rolet e mirëpaguara të vendimmarrjes, ku mbanin vetëm 19% të këtyre pozitave. Sipas Ligjit për Barazi Gjinore, Ministria duhet të sigurojë përfaqësim të barabartë të grave dhe burrave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, të përcaktuara në masën prej 50% për secilën gjini. Megjithatë, ministria nuk parashikon hapjen e pozitave të reja në vitin 2018.

Tabela 2. Punonjësit në MD sipas gjinisë dhe nivelit bruto të pagës në periudhën 2015-2018 ¹³							
Viti	Niveli i pagës	Gjithsej punonjës në secilin nivel të pagave	# dhe % e burrave	Shuma e shpenzuar për burrat	# dhe % e grave	Shuma e shpenzuar për gratë	Shuma totale e shpenzuar
2015	201 - 400	1	1 (100%)	5,841€ (60%)	0 (0%)	3,972€ (40%)	9,813€
	401 - 600	32	16 (50%)	109,023€ (52%)	16 (50%)	98,672€ (48%)	207,694€
	600 +	31	23 (74%)	173,646€ (84%)	8 (26%)	33,731€ (16%)	207,377€
	Total	64	40 (63%)	288,510€ (68%)	24 (38%)	136,374€ (32%)	424,884€
2016	201 - 400	0	0 (0%)	143€ (100%)	0 (0%)	0€ (0%)	143€
	401 - 600	38	19 (50%)	110,363€ (52%)	19 (50%)	99,876€ (48%)	210,240€
	600 +	27	22 (81%)	221,762€ (83%)	5 (19%)	44,723€ (17%)	266,485€
	Total	65	41 (63%)	332,269€ (70%)	24 (37%)	144,599€ (30%)	476,868€
2017 (jan.-prill)	201 - 400	0	0 (0%)	349€ (100%)	0 (0%)	0€ (0%)	349€
	401 - 600	38	19 (50%)	39,187€ (53%)	19 (50%)	35,196€ (47%)	74,383€
	600 +	27	22 (81%)	67,581€ (86%)	5 (19%)	10,899€ (14%)	78,481€
	Total	65	41 (63%)	107,117€ (70%)	24 (37%)	46,096€ (30%)	153,213€
Planifikuar për 2018-ën	201 - 400	3	1 (33%)	4,626€ (33%)	2 (67%)	9,441€ (67%)	14,067€
	401 - 600	41	22 (54%)	127,543€ (53%)	19 (46%)	113,839€ (47%)	241,382€
	600 +	22	19 (86%)	180,512€ (86%)	3 (14%)	30,506€ (14%)	211,018€
	Total	66	42 (64%)	312,682€ (67%)	24 (36%)	153,786€ (33%)	466,468€

¹³ Numri i anëtarëve të personelit në vitin 2015 dhe 2016 është i njëjtë me numrin në dhjetorin e atij viti, ndërsa pagat dhe mëditjet janë shuma e të gjitha shpenzimeve për punonjësit në secilin vit përkatës. Kjo është arsyeja pse në disa prej rasteve nuk renditet asnjë punonjës (meqenëse nuk kishte asnjë në dhjetor), por shpenzimet janë paraqitur (nga muajt e mëparshëm). Kjo mbetet e vërtetë për prillin e 2017-ës dhe për të gjitha tabelat e punonjësve në këtë raport, me përjashtim të Divizionit të Prokurimit. Të dhëna të pranuar nga Divizioni i Burimeve Njerëzore, 30 gusht 2017.

Në përgjithësi, gratë përbënin pjesën më të madhe të punonjësve të MD-së që merrnin pjesë në trajnime çdo vit. Gratë përbënin 55% në vitin 2015, 66% në vitin 2016 dhe 67% që prej marsit të vitit 2017 (tabela 3).

Tabela 3. Personeli i MD-së që merr pjesë në trajnime, sipas gjinisë, për periudhën 2015-2017 ¹⁴			
Viti	# i përgjithshëm i pjesëmarrësve	# dhe % e grave	# dhe % e burrave
2015	51	28 (55%)	23 (45%)
2016	41	27 (66%)	14 (34%)
2017 (Jan. - Mar.)	9	6 (67%)	3 (33%)
Total	101	61 (60%)	40 (40%)

Me anë të një analize të mëtejshme cilësore do të mund të shqyrtoheshin shkaqet pse numri i punonjësve gra që kanë marrë pjesë në trajnime është më i madh sesa ai i burrave. Ndërkohë që përfaqësimi më i barabartë në trajnim do të kontribuonte në shpenzime më të ekuilibruara të gratë dhe burrat, ndoshta trajnimet e ofruara mund të konsiderohen edhe si një masë afirmative në funksion të ofrimit të grave njohuri dhe shprehje të reja, duke përmirësuar kështu mundësitë e tyre për përparim në karrierë dhe/ose ngritje në detyrë. Në këtë rast, trajnimet shpesh për gratë mund të shihen si një nismë pozitive nga ana e MD-së.

Mallrat dhe shërbimet

Në tabelën 4 paraqitet një numër më i vogël i grave sesa i burrave që kanë kryer vizita zyrtare në emër të MD-së, duke përbërë kështu 20% të personave që udhëtonin në vitet 2015 dhe 2016 dhe 29% në vitin 2017. Në lidhje me këtë, Ministria ka shpenzuar për gratë 21% të shpenzimeve që kanë të bëjnë me udhëtimet zyrtare në vitin 2015, 15% në vitin 2016 dhe 17% deri në korrik të vitit 2017.

Tabela 4. Pjesëmarrja e anëtarëve të personelit të MD-së, dietat, akomodimi, biletat dhe shpenzime të tjera për udhëtime zyrtare, sipas gjinisë, në periudhën 2015-2017 ¹⁵			
Viti	2015	2016	2017 (janar-korrik)
# i përgjithshëm i udhëtimeve zyrtare	270 (100%)	305 (100%)	42 (100%)
# dhe % e udhëtimeve zyrtare ku kanë marrë pjesë gra	53 (20%)	61 (20%)	12 (29%)
# dhe % e udhëtimeve zyrtare ku kanë marrë pjesë burra	214 (79%)	244 (80%)	30 (71%)
# dhe % e pjesëmarrësve me gjini të paidentifikuar	3 (1%)	0 (0%)	0 (0%)
Shuma e përgjithshme e shpenzuar për ushqim (dietë)	86,896€ (100%)	98,570€ (100%)	39,244€ (100%)
Shpenzimi për gratë	18,629€ (21%)	17,682€ (18%)	7,572€ (19%)
Shpenzimi për burrat	67,825€ (78%)	80,888€ (82%)	31,673€ (81%)
Shpenzuar për pjesëmarrësit me gjini të paidentifikuar	442€ (1%)	0€ (0%)	0€ (0%)
Shuma totale e shpenzuar për akomodim	61,210€ (100%)	74,309€ (100%)	29,548€ (100%)
Shpenzimi për gratë	11,283€ (18%)	8,275€ (11%)	3,293€ (11%)
Shpenzimi për burrat	48,929€ (80%)	66,034€ (89%)	26,255€ (89%)
Shpenzuar për pjesëmarrësit me gjini të paidentifikuar	997€ (2%)	0€ (0%)	0€ (0%)
Shuma totale e përdorur për shpenzime të tjera	16,429€ (100%)	17,931€ (100%)	9,276€ (100%)
Shpenzimi për gratë	5,037€ (31%)	2,807€ (16%)	1,245€ (13%)

¹⁴ Në këtë tabelë nuk përfshihen informatat lidhur me trajnimet ku kanë marrë pjesë persona nga kabineti i Ministrit.

¹⁵ Të ndara sipas gjinisë dhe të llogaritura nga RrGK-ja, duke u mbështetur në emrat e pjesëmarrësve.

Shpenzimi për burrat	11,246€ (68%)	15,125€ (84%)	8,032€ (87%)
Shpenzuar për pjesëmarrësit me gjini të paidentifikuar	146€ (1%)	0€ (0%)	0€ (0%)
Shuma e përgjithshme e shpenzuar për dreka zyrtare jashtë vendit	148€ (100%)	901€ (100%)	1,011€ (100%)
Shpenzimi për gratë	66€ (45%)	0€ (0%)	1,011€ (100%)
Shpenzimi për burrat	82€ (55%)	901€ (100%)	0€ (0%)
Shuma e përgjithshme e shpenzuar për udhëtime zyrtare	164,683€ (100%)	191,711€ (100%)	79,079€ (100%)
Shuma e përgjithshme e shpenzuar për gratë	35,016€ (21%)	28,764€ (15%)	13,121€ (17%)
Shuma totale e shpenzuar për burrat	128,082€ (78%)	162,947€ (85%)	65,959€ (83%)
Shuma e përgjithshme e shpenzuar për pjesëmarrësit me gjini të paidentifikuar	1,585€ (1%)	0€ (0%)	0€ (0%)

Subvencionet dhe transferet

Procesi i alokimit të subvencioneve sipas projektit të MD-së fillon me një thirrje fillestare publike për aplikime për projekte. Në fushëveprimin e projektit përfshihet, por jo vetëm, kultura, arti, sporti, letërsia, hulumtimet shkencore, të rinjtë dhe arsimi. Shuma maksimale e alokuar për një projekt është 5,000 euro. Pjesëmarrësit mund të jenë subjekte vendase ose të huaja, fizike ose juridike.¹⁶ Aktualisht, gratë përfitojnë më pak nga subvencionet e MD-së sesa burrat, duke përbërë kështu rreth një të pestën e përfituesve gjatë periudhës 2015-maj 2017 dhe marrin vetëm 20% të buxhetit të përgjithshëm për subvencione (tabela 5).

Tabela 5. Subvencionet e MD-së sipas gjinisë, 2015-2018						
Viti	# i përfituesve	# i grave	# i burrave	Shuma e përgjithshme e shpenzuar për gratë	Shuma e përgjithshme e shpenzuar për burrat	Shuma e përgjithshme e shpenzuar për gratë dhe burrat
2015	69	14 (20%)	55 (80%)	35,820€ (28%)	93,250€ (72%)	129,070€
2016	67	14 (21%)	53 (79%)	24,675€ (19%)	104,152€ (81%)	128,827€
2017 (janar-maj)	64	15 (23%)	49 (77%)	21,850€ (20%)	88,150€ (80%)	110,000€ ¹⁷
Planifikuar për 2018-ën	71	30 (42%)	41 (58%)	50,000€ (38%)	80,000€ (62%)	130,000€

Objektivat e rekomanduara

Mbështetur në këtë analizë gjinore, MD-ja mund të marrë hapa konkret drejt çuarjes përpara të barazisë gjinore në shpenzimet e veta në vitet e ardhshme. Të dhënat e kontrollit mund të shërbejnë për caktimin e synimeve për tregues specifikë të lidhur me buxhetin. Për shembull, në tregues dhe synime mund të bëjnë pjesë këto raste:

1. Kur hapen vende pune, të rritet pjesa e punonjëseve, duke përfshirë edhe pozitat e vendimmarrjes, nga 37% deri në prill të vitit 2017;
2. Të rritet përqindja e punonjëseve që kryejnë vizita zyrtare nga 20% që ishte në vitin 2016 në 30% në vitin 2018, duke rritur kështu shpenzimet për gratë nga 15% në 25%;
3. Të rritet përqindja e subvencioneve që u shpërndahen grave nga 23% që ishte në maj të vitit 2017 në 42% në vitin 2018, duke rritur kështu shpenzimet për gratë nga 20% në 38%;

¹⁶ Faqja e internetit e MD-së, Rregulloret, "Rregullorja nr. 1/2016 për Kriteret dhe Mënyrën e Subvencionimit të Projekteve për Diasporën", marrë nga: <http://gjuhaime.rks-gov.net/desk/inc/media/909040BF-524D-4BC2-8EB8-69F7338A42F4.pdf>.

¹⁷ Ministria e Diasporës ka planifikuar të japë 130,000 € në subvencione në vitin 2017. Deri në maj të vitit 2017, 110,000 euro ishin dhënë për projekte të organizatave joqeveritare (OJQ).

4. Të përmirësohet mbledhja dhe përdorimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë, në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore, për të gjitha departamentet dhe divizionet e Ministrisë.

Aktivitetet e rekomanduara

Për t'i arritur këto synime, MD-ja mund të ndër marrë veprime pozitive:

1. Për të rekrutuar, punësuar dhe ngritur në detyrë gra të kualifikuara, duke përdorur masat afirmative atëherë kur hapen vende të reja pune, në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore, i cili bën thirrje që gratë dhe burrat të përfaqësohen në masën 50% të të gjitha nivelet. Kjo do të kontribuojë në përmirësimin e ekuilibrit gjinor në shpenzime për pagat dhe mëditjet e burrave dhe grave.
2. Për të përzgjedhur më shumë gra për të marrë pjesë në udhëtime zyrtare, duke kontribuar kështu drejt barazisë në shpenzime për vizita zyrtare (shpenzime për dieta, akomodime dhe shpenzime të tjera).
3. Për të përdorur masa afirmative me qëllim të përmirësimit të ekuilibrit gjinor midis pranuesve të subvencioneve, duke u dhënë fonde një numri më të madh të grave të kualifikuara. Kjo do të kontribuojë në ekuilibrimin më të mirë të shpenzimeve për gratë dhe burrat.
4. Për të krijuar një bazë të thjeshtë të të dhënave në Excel, të ndara sipas gjinisë, me qëllim që të dokumentohet pjesëmarrja e burrave dhe grave në udhëtime zyrtare, grupe të punës, konsultime publike, trajnime dhe në aktivitete të tjera.

Zyra e Ministrit

Zyra e Ministrit përfaqëson MD-në, propozon projektligje dhe politika dhe siguron zbatimin e politikave të Ministrisë. Kjo zyrë planifikon buxhetin e Ministrisë dhe ndan fondet nga buxheti i Kosovës, përmes një procesi transparent e të përgjegjshëm. Zyra e Ministrit gjithashtu ngre ndërgjegjësimin për mashtrimet dhe merr masa për parandalimin e mashtrimit dhe korrupsionit. Më tej, ajo siguron që politikat ministrore të diskutohen nga grupet e synuara dhe nga palë të tjera të interesuara.¹⁸

Pagat dhe mëditjet

Raporti i punonjësve ra nga 27% e të gjithë punonjësve në vitin 2015 në 24% në vitin 2016, por u rrit lehtësisht në 25% deri në Prill të vitit 2017 (tabela 6). Shpenzimet për pagat dhe mëditjet e grave, megjithatë, janë zvogëluar çdo vit, duke përbërë 17% të shpenzimeve të përgjithshme deri më tani, në vitin 2017.

Tabela 6. Punonjësit e Zyrës së Ministrit sipas gjinisë dhe nivelit të pagës (bruto), 2015-2017							
Viti	Niveli i pagës	Gjithsej punonjës në secilin nivel të pagave	# dhe % e burrave	Shuma e shpenzuar për burrat	# dhe % e grave	Shuma e shpenzuar për gratë	Shuma totale e shpenzuar
2015	201 - 400	1	1 (100%)	945€ (71%)	0 (0%)	394€ (29%)	1,339€
	401 - 600	6	4 (67%)	18,465€ (69%)	2 (33%)	8,347€ (31%)	26,811€
	600 +	8	6 (75%)	66,112€ (83%)	2 (25%)	13,539€ (17%)	79,651€
	Total	15	11 (73%)	85,521€ (79%)	4 (27%)	22,280€ (21%)	107,801€
2016	201 - 400	0	0 (0%)	0€ (0%)	0 (0%)	0€ (0%)	0€
	401 - 600	9	6 (67%)	31,893€ (71%)	3 (33%)	12,738€ (29%)	44,631€
	600 +	8	7 (88%)	86,594€ (87%)	1 (13%)	13,315€ (13%)	99,908€
	Total	17	13 (76%)	118,487€ (82%)	4 (24%)	26,052€ (18%)	144,539€

¹⁸ Qeveria e Kosovës, Rregullorja nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, neni 9, marrë nga: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullorja_02-2011-e_miraturar nga_Qeveria-finale.pdf.

2017 (janar-prill)	201 - 400	0	0 (0%)	0€ (0%)	0 (0%)	0€ (0%)	0€
	401 - 600	9	5 (56%)	11,025€ (60%)	4 (44%)	7,371€ (40%)	18,396€
	600 +	7	7 (100%)	25,879€ (100%)	0 (0%)	0€ (0%)	25,879€
	Total	16	12 (75%)	36,904€ (83%)	4 (25%)	7,371€ (17%)	44,274€

Mallrat dhe shërbimet

Numri i grave që kanë marrë pjesë në udhëtime zyrtare ishte më i ulët, duke përbërë kështu 15% të të gjithë punonjësve që kryenin udhëtime zyrtare në vitin 2015, 12% në vitin 2016, dhe 25% deri në korrik të vitit 2017. Për këtë arsye, burrat kanë pranuar më shumë sesa gratë fonde nga buxheti, të cilat ishin alokuar për dietat, akomodimi dhe shpenzime të tjera.

Tabela 7. Pjesëmarrja e anëtarëve të personelit të Kabinetit të Ministrit, dietat, akomodimi, biletat dhe shpenzime të tjera për udhëtime zyrtare, sipas gjinisë, në periudhën 2015-2017¹⁹			
Viti	2015	2016	2017 (janar-korrik)
# i përgjithshëm i udhëtimeve zyrtare	104 (100%)	121 (100%)	8 (100%)
# dhe % e udhëtimeve zyrtare ku kanë marrë pjesë gra	16 (15%)	14 (12%)	2 (25%)
# dhe % e udhëtimeve zyrtare ku kanë marrë pjesë burra	86 (83%)	107 (88%)	6 (75%)
# dhe % e pjesëmarrësve me gjini të paidentifikuar	2 (2%)	0 (0%)	0 (0%)
Shuma e përgjithshme e shpenzuar për ushqim (dietë)	32,338€ (100%)	34,807€ (100%)	€10,191 (100%)
Shpenzimi për gratë	5,052€ (16%)	3,787€ (11%)	774€ (8%)
Shpenzimi për burrat	26,845€ (83%)	31,019€ (89%)	9,417€ (92%)
Shpenzuar për pjesëmarrësit me gjini të paidentifikuar	442€ (1%)	0€ (0%)	0€ (0%)
Shuma totale e shpenzuar për akomodim	23,788€ (100%)	27,033€ (100%)	12,540€ (100%)
Shpenzimi për gratë	3,468€ (15%)	1,238€ (5%)	305€ (2%)
Shpenzimi për burrat	20,007€ (84%)	25,795€ (95%)	12,234€ (98%)
Shpenzuar për pjesëmarrësit me gjini të paidentifikuar	313€ (1%)	0€ (0%)	0€ (0%)
Shuma totale e përdorur për shpenzime të tjera	7,410€ (100%)	4,790€ (100%)	3,088€ (100%)
Shpenzimi për gratë	2,581€ (35%)	98€ (2%)	105€ (3%)
Shpenzimi për burrat	4,683€ (63%)	4,692€ (98%)	2,983€ (97%)
Shpenzuar për pjesëmarrësit me gjini të paidentifikuar	146€ (2%)	0€ (0%)	0€ (0%)
Shuma e përgjithshme e shpenzuar për dreka zyrtare jashtë vendit	0€ (0%)	675€ (100%)	0€ (0%)
Shpenzimi për gratë	0€ (0%)	0€ (0%)	0€ (0%)
Shpenzimi për burrat	0€ (0%)	675€ (100%)	0€ (0%)
Shuma e përgjithshme e shpenzuar për udhëtime zyrtare	63,536€ (100%)	67,305€ (100%)	25,818€ (100%)
Shuma e përgjithshme e shpenzuar për gratë	11,100€ (17%)	5,124€ (8%)	1,184€ (5%)
Shuma totale e shpenzuar për burrat	51,535€ (81%)	62,182€ (92%)	24,634€ (95%)
Shuma e përgjithshme e shpenzuar për pjesëmarrësit me gjini të paidentifikuar	901€ (1%)	0€ (0%)	0€ (0%)

¹⁹ Të ndara sipas gjinisë dhe të llogaritura nga RRGK-ja, duke u mbështetur në emrat e pjesëmarrësve.

Objektivat e rekomanduara

1. Të rritet përqindja e punonjësve të kualifikuara në pozita më të paguara nga 25% që ishte në prill të vitit 2017, përmes punësimit dhe ngritjes në detyrë atëherë kur ka vende pune të hapura, duke rritur në këtë mënyrë shpenzimet për gratë nga 17%.
2. Të rritet përqindja e punonjësve që kryejnë vizita zyrtare nga 12% që ishte në vitin 2016 në 30% në vitin 2018, duke rritur kështu shpenzimet për dietat dhe shpenzime të tjera për udhëtime zyrtare të grave nga 8% në 16%.

Aktivitetet e rekomanduara

1. Të përdoren masa afirmative për të punësuar dhe ngritur në detyrë një numër më të madh të grave të kualifikuara, në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore.
2. Të emërohen më shumë gra për të kryer udhëtime zyrtare.

Administrata Qendrore

Administrata Qendrore menaxhon buxhetet e Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm, Divizionit të Prokurimit Publik, Divizionit të Marrëdhënieve me Publikun, Divizionit të Auditimit të Brendshëm, Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme dhe divizioneve të tij, Departamentit Ligjor dhe divizioneve të tij, Departamentit për Qendrat Kulturore në Diasporë dhe divizionet e tij, tri qendrave kulturore, Departamentit të Mbrojtjes dhe Kultivimit të Arsimit dhe Kulturës në Diasporë dhe divizionet e tij, dhe Departamenti për Hulumtim dhe Përkrahje të Investimeve në Diasporë dhe divizionet e tij.

Pagat dhe mëditjet

Siç tregohet në tabelën 8, në prill të vitit 2017, gratë përbënin 41% të punonjësve që punonin te të gjitha departamentet dhe divizionet sipas kodit buxhetor të Administratës Qendrore; gratë pranonin 36% të shpenzimeve totale për rroga bruto. Pozita e udhëheqësit të Departamentit Ligjor kishte qenë e lirë që prej marsit të vitit 2017. Krahas kësaj, në vitin 2017, në Departamentin për Mbrojtjen dhe Kultivimin e Arsimit dhe Kulturës në Diasporë, do të hapet një vend pune i ri.

Viti	Niveli i pagës	Gjithsej punonjës në secilin nivel të pagave	# dhe % e burrave	Shuma e shpenzuar për burrat	# dhe % e grave	Shuma e shpenzuar për gratë	Shuma totale e shpenzuar
2015	201 - 400	0	0 (0%)	4,897€ (58%)	0 (0%)	3,577€ (42%)	8,474€
	401 - 600	26	12 (46%)	90,558€ (50%)	14 (54%)	90,324€ (50%)	180,882€
	600 +	23	17 (74%)	107,535€ (84%)	6 (26%)	20,192€ (16%)	127,727€
	Total	49	29 (59%)	202,990€ (64%)	20 (41%)	114,094€ (36%)	317,083€
2016	201 - 400	0	0 (0%)	143€ (100%)	0 (0%)	0€ (0%)	143€
	401 - 600	29	13 (45%)	78,470€ (47%)	16 (55%)	87,139€ (53%)	165,610€
	600 +	19	15 (79%)	135,169€ (81%)	4 (21%)	31,408€ (19%)	166,577€
	Total	48	28 (58%)	213,782€ (64%)	20 (42%)	118,547€ (36%)	332,329€

²⁰ Numri i personelit në këto tabela është vetëm për deri në prill të vitit 2017, ndërkohë që shumat e shpenzuara për personelin janë mbledhur si shumë nga të gjithë muajt deri në prill. Për këtë arsye, është shpenzuar një shumë parash edhe pse në tabelë nuk figuron asnjë punonjës.

2017 (janar-prill)	201 - 400	0	0 (0%)	349€ (100%)	0 (0%)	0€ (0%)	349€
	401 - 600	29	14 (48%)	28,162€ (50%)	15 (52%)	27,826€ (50%)	55,989€
	600 +	20	15 (75%)	41,701€ (79%)	5 (25%)	10,900€ (21%)	52,602€
	Total	49	29 (59%)	70,213€ (64%)	20 (41%)	38,725€ (36%)	108,939€

Mallrat dhe shërbimet

Gratë që punojnë në Administratën Qendrore dhe departamentet dhe divizionet që janë në kuadrin e kodit të saj buxhetor, kryejnë udhëtime zyrtare më rrallë sesa burrat; gratë përbënin 22% të pjesëmarrësve në 165 udhëtime zyrtare të kryera në vitin 2015, 26% në vitin 2016 dhe 29% deri në korrik të 2017-ës. Në këtë mënyrë, burrat kanë pranuar më shumë shpenzime nga kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve sesa gratë, lidhur me dietat, akomodimin dhe shpenzimet e tjera.

Tabela 9. Pjesëmarrja e anëtarëve të personelit të Administratës Qendrore, dietat, akomodimi, biletat dhe shpenzime të tjera për udhëtime zyrtare, sipas gjinisë, në periudhën 2015-2017 ²¹			
Viti	2015	2016	2017 (janar-korrik)
# i përgjithshëm i udhëtimeve zyrtare	165 (100%)	184 (100%)	34 (100%)
# dhe % e udhëtimeve zyrtare ku kanë marrë pjesë gra	37 (22%)	47 (26%)	10 (29%)
# dhe % e udhëtimeve zyrtare ku kanë marrë pjesë burra	128 (78%)	137 (74%)	24 (71%)
# dhe % e pjesëmarrësve me gjini të paidentifikuar	0 (0%)	0 (0%)	0 (0%)
Shuma e përgjithshme e shpenzuar për ushqim (dietë)	54,559€ (100%)	63,763€ (100%)	29,054€ (100%)
Shpenzimi për gratë	13,578€ (25%)	13,895€ (22%)	6,798€ (23%)
Shpenzimi për burrat	40,981€ (75%)	49,869€ (78%)	22,255€ (77%)
Shpenzuar për pjesëmarrësit me gjini të paidentifikuar	0€ (0%)	0€ (0%)	0€ (0%)
Shuma totale e shpenzuar për akomodim	36,737€ (100%)	47,275€ (100%)	17,008€ (100%)
Shpenzimi për gratë	7,815€ (21%)	7,037€ (15%)	2,988€ (18%)
Shpenzimi për burrat	28,922€ (79%)	40,239€ (85%)	14,020€ (82%)
Shpenzuar për pjesëmarrësit me gjini të paidentifikuar	0€ (0%)	0€ (0%)	0€ (0%)
Shuma totale e përdorur për shpenzime të tjera	9,019€ (100%)	13,141€ (100%)	6,188€ (100%)
Shpenzimi për gratë	2,457€ (27%)	2,708€ (21%)	1,140€ (18%)
Shpenzimi për burrat	6,562€ (73%)	10,433€ (79%)	5,049€ (82%)
Shpenzuar për pjesëmarrësit me gjini të paidentifikuar	0€ (0%)	0€ (0%)	0€ (0%)
Shuma e përgjithshme e shpenzuar për dreka zyrtare jashtë vendit	148€ (100%)	225€ (100%)	1,011€ (100%)
Shpenzimi për gratë	66€ (45%)	0€ (0%)	1,011€ (100%)
Shpenzimi për burrat	82€ (55%)	225€ (100%)	0€ (0%)
Shuma e përgjithshme e shpenzuar për udhëtime zyrtare	100,462€ (100%)	124,405€ (100%)	53,261€ (100%)
Shuma e përgjithshme e shpenzuar për gratë	23,916€ (24%)	23,640€ (19%)	11,937€ (22%)
Shuma totale e shpenzuar për burrat	76,546€ (76%)	100,765€ (81%)	41,324€ (78%)
Shuma e përgjithshme e shpenzuar për pjesëmarrësit me gjini të paidentifikuar	€0 (0%)	0€ (0%)	0€ (0%)

Objektivat e rekomanduara

1. Të rritet përqindja e punonjësve në Administratën Qendrore dhe të gjitha departamentet dhe divizionet e saj, kur të hapen vende të reja pune, nga 41% që është në prill të 2017-ës në 45% në vitin 2017, duke kontribuar në rritjen e shpenzimeve për gratë nga 36% në 45%.

²¹ Të ndara sipas gjinisë dhe të llogaritura nga RrGK-ja, duke u mbështetur në emrat e pjesëmarrësve.

2. Të rritet përqindja e udhëtimeve zyrtare të bëra nga gratë nga 26% që ishte në vitin 2016 në 30% në vitin 2018, duke rritur kështu shpenzimet për gratë nga 19% në 25%.

Aktivitetet e rekomanduara

1. Të ndërmerren veprime afirmative për të punësuar gra dhe për t'i ngritur ato në detyrë në Administratën Qendrore dhe në departamentet dhe divizionet e saj.
2. Të përzgjidhen më shumë gra për të marrë pjesë në udhëtime zyrtare.

Divizioni i Prokurimit Publik

Divizioni i Prokurimit Publik i raporton Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm. Ai menaxhon strategjinë, planifikimin dhe zbatimin e politikës dhe kërkesave të prokurimit publik, në pajtim me ligjet, rregulloret dhe procedurat përkatëse. Ky divizion është përgjegjës edhe për përcaktimin e metodologjisë për prokurimin me anë të tenderëve dhe procedurat për vlerësimin e çmimit, duke mbështetur në të njëjtën kohë menaxhmentin për marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me mosmarrëveshjet kontraktuale.

Në Kosovë, sipas ligjit, procedurat e prokurimit dhe operacionet tashmë mund të konsiderohen faktorë socialë: "Autoritetet kontraktuese mund të vendosin, ndër të tjerash, kushte kontraktuale specifike të cilat mundësojnë marrjen parasysh të objektivave sociale".²² Në mesin e këtyre objektivave është "detyrimi për të zbatuar, gjatë ekzekutimit të kontratës, masat që janë projektuar për të nxitur barazinë midis burrave dhe grave apo diversitetit në baza tjera."²³ Prandaj, si autoritet kontraktues, MD-ja mund të ndërmarrë veprime afirmative në funksion të nxitjes së bizneseve që janë pronë e grave dhe/ose me shumë punonjëse, që të aplikojnë.

Megjithatë, deri në mars të vitit 2017, Divizioni nuk ka ndërmarrë veprime afirmative si pjesë të proceseve të prokurimit për të çuar më tutje barazinë gjinore. As nuk ka mbledhur apo ruajtur të dhëna të ndara sipas gjinisë, në lidhje me kompanitë furnitore të regjistruara dhe për personelin e tyre.²⁴ Megjithatë, Divizioni planifikon të përfshijë perspektivën gjinore në kontratat e tij të ardhshme me furnitorë të mundshëm, gjatë punës së tij.²⁵

Objektivat e rekomanduara

1. Të rritet përfshirja e objektivave sociale, domethënë barazia gjinore në kontrata, duke i detyruar kontraktorët të zbatojnë gjatë ekzekutimit të kontratës masa të projektuara për nxitjen e barazisë gjinore.
2. Të përmirësohet mbledhja, mirëmbajtja dhe analiza e të dhënave të ndara sipas gjinisë, të cilat kanë të bëjnë me prokurimin, me qëllim që të krijohen të dhëna kontrolluese dhe për të ofruar të dhëna për caktimin e objektivave për përdorimin e proceseve të prokurimit publik për të çuar më tej barazinë gjinore në Kosovë.

Aktivitetet e rekomanduara

1. Me përkrahjen e ZBGJ-së dhe ekspertëve gjinorë, të përfshihet në mostrën e kontratës së prokurimit një tekst i standardizuar me të cilin kontraktorëve u kërkohet të çojnë më tej barazinë gjinore. Në proceset e prokurimit, të nxiten bizneset e kontraktuara që të sigurojnë në ekuilibër midis grave dhe burrave në të gjitha nivelet në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore. Të merret parasysh ndarja e pikëve

²² Republika e Kosovës, Ligji nr. 05/L-068, për ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, marrë nga: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-068%20sh.pdf>.

²³ Ibid, neni 17.

²⁴ Intervistë e RRGK-së me udhëheqësin e Divizionit, 27 mars 2017.

²⁵ Ibid.

shtesë në vlerësimin me pikë të kërkesave të aplikantëve të cilat kanë ekuilibër gjinor në personelin e tyre kyç. Të përfshihen në kontrata deklarata që i bëjnë kontraktorët përgjegjës për zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore, duke siguruar zbatimin e parimeve të mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, dhe duke siguruar që të zbatohen politikat dhe praktikat kundër diskriminimit.

2. Të mblidhen dhe të mirëmbahen të dhëna të ndara sipas gjinisë, lidhur me kompanitë furnitore dhe personelin e tyre, duke u kërkuar kontraktorëve që t'i përfshijnë këto të dhëna në ofertat dhe raportet e tyre.

Divizioni i Komunikimit me Publikun

Divizioni i Komunikimit me Publikun e ndihmon Ministrinë me organizimin e konferencave të shtypit, deklaratave për shtyp dhe publikime të tjera mediatike. Gjithashtu, propozon dhe zbaton plane të komunikimit dhe informimit të publikut.

RRGK-ja nuk ka marrë asnjë të dhënë nga ky Divizion dhe, për këtë arsye, nuk ka pasur mundësi të shqyrtojë dhe komentojë lidhur me planet e tyre për komunikim dhe informim të publikut nga pikëpamja gjinore. Megjithatë, është me rëndësi që ky Divizion të sigurojë që në këto plane të integrohet perspektiva gjinore, duke përfshirë edhe mënyrën se si MD-ja do të arrijë të gratë e burrat të ndryshëm me informata lidhur me programet dhe shërbimet e MD-së.

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme përbëhet nga Divizioni i Burimeve Njerëzore, Divizioni i Teknologjisë së Informacionit dhe Shërbimeve të Logjistikës, dhe Divizioni i Buxhetit dhe Financave. Ai monitoron dhe përkrah shërbimet e divizionit, duke përfshirë procedurat e rekrutimit, duke siguruar që ato të jenë në harmoni me legjislacionin aktual. Gjithashtu, departamenti përgatit, zbaton, vlerëson dhe raporton për buxhetin e Ministrisë dhe koordinon pagesën në kohë të detyrimeve financiare.²⁶

Objektivat e rekomanduara

1. Të institucionalizohet më tej BPGJ-ja në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore.
2. Të përmirësohet përdorimi i masave afirmative në procedurat e rekrutimit.

Aktivitetet e rekomanduara

1. Duke përdorur rekomandimet që jepen në këtë raport, të vazhdohet nxitja e të gjitha departamenteve dhe divizioneve që të zbatojnë në mënyrë të plotë përgjegjësitë e tyre lidhur me BPGJ-në, duke përfshirë mirëmbajtjen e të dhënave të ndara sipas gjinisë dhe kryerjen e analizave gjinore për të ofruar informata mbi të cilat të mbështeten politikat dhe programet.
2. Të përfshihen masat afirmative si pjesë e procesit të rekrutimit, në funksion të rekrutimit aktiv të më shumë grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, duke qenë se ato bëjnë pjesë në gjininë e nënpërfaqësuar në Ministri.

Departamenti Ligjor

Departamenti Ligjor menaxhon Divizionin për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit dhe Divizionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjeve, Mbështetjes Ligjore dhe Bashkëpunimit

²⁶ MD, "Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme", marrë nga: <http://med.rks.gov.net/Faqe.aspx?id=29&l=0>.

Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit. Ai ofron përkrahje ligjore brenda fushëveprimit të Ministrisë, është përgjegjës për hartimin e legjislacionit parësor dhe dytësor, dhe përgatit dokumente strategjike dhe legjislative, duke përfshirë rekomandime dhe udhëzime. Departamenti harmonizon legjislacionin e *Acquis Communautaire* të Bashkimit Evropian (BE) me legjislacionin përkatës të ndërlidhur me punën e MD-së në Kosovë. Për të përfaqësuar MD-në në konteste gjyqësore, Departamenti Ligjor bashkëpunon edhe me Ministrinë e Drejtësisë.²⁷

Sipas udhëheqësit të Departamentit, Departamenti zbaton ligje që kanë të bëjnë me diasporën, bën rekomandime dhe ndryshime në ligje, interpreton aktet nënligjore dhe harton marrëveshje dhe vendime për Sekretarin e Përgjithshëm.²⁸ Në vitin 2017, Departamenti ka punuar për një dokument koncept dhe një ligj të ri për diasporën. Në vitin 2018, ky Departament hartoi dy strategji. E para, rregullorja e re për subvencione do të kërkojë që financimi që u jepet organizatave joqeveritare (OJQ) përmes subvencioneve dhe granteve të rregullohet në nivelin qeveritar. E dyta, lidhur me strukturën organizative të MD-së, do të hyjë në fuqi në vitin 2018, menjëherë pas hapjes së vendeve të reja të punës.

Aktualisht Departamenti po adreson statusin e qendrave kulturore, meqenëse ato nuk janë institucione të pavarura. Në harmoni me këtë strategji, Departamenti po punon edhe për rritjen e përfshirjes së Ministrisë në Kuvend. Departamenti Ligjor ka propozuar *Strategjinë për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018* dhe do të hartojë një propozim për strategjinë e re në vitin 2018. ZBGJ-ja nuk mori pjesë në grupet e mëparshme të punës për hartimin e ligjeve dhe rregulloreve, edhe pse kjo kërkohej nga Ligji për Barazi Gjinore. Sipas udhëheqësit të Departamentit, kjo ka ndodhur sepse grupet e punës kanë diskutuar çështje ligjore specifike dhe kanë përdorur zhargon tekniko-juridik. Pavarësisht kësaj, që ZBGJ-ja t'i kryejë përgjegjësitë e saj, është tepër e rëndësishme që ajo të jetë pjesë e këtyre proceseve, duke zhvilluar ekspertizë teknike për t'i përcjellë ato, sipas nevojës.

Gjatë hartimit të strategjive dhe ligjeve që kanë të bëjnë me diasporën, Departamenti organizon konsultime me publikun. Konsultimet më të fundit u mbajtën në prill dhe maj të vitit 2017.²⁹ Departamenti as nuk mbledh dhe as nuk mban të dhëna të ndara sipas gjinisë në lidhje me këto konsultime, edhe pse kjo kërkohej me Ligjin për Barazi Gjinore. Meqenëse të komentet nga konsultimet me publikun mungojnë, MD-ja mbledh të dhëna të tjera shtesë përmes një platforme në internet për konsultime me publikun, e cila ndodhet në faqen e internetit të Zyrës së Kryeministrit.³⁰ Kjo platformë siguron që të përmbushen standardet minimale për konsultimet me publikun, në pajtim me Rregulloren nr. 05/2016.³¹ Gjithashtu, përmes saj, anëtarëve të diasporës u ofrohet mundësia të marrin pjesë në konsultimet me publikun. Në kohën kur u bë kjo analizë, konsultimet me publikun ishin shpallur në platformë midis janarit dhe qershorit të vitit 2017. Meqenëse Departamenti nuk ka mbajtur të dhëna të ndara sipas gjinisë lidhur me pjesëmarrësit në konsultime, është e paqartë se në çfarë shkalle kanë marrë pjesë gratë dhe burrat. Në aspektin e përmbajtjes, gjatë konsultimeve me publikun nuk është ngritur asnjë çështje që ka të bëjë me çështjet gjinore dhe që më vonë do të adresoheshin në ligje dhe politikat e hartuara nga Departamenti.

Departamenti ka një rrjet prej 130 juristësh me të cilët konsultohet kur harton rregulloret dhe strategjitë. Gratë përbënin 45% të anëtarëve të tij në periudhën 2015-2017; jo të gjithë juristët janë të regjistruar në MD.³² Pritej që në faqen e internetit të Odës së Avokatëve të Kosovës, që prej vitit 2016, të kishte një listë të juristëve nga diaspora. Megjithatë, kjo faqe interneti vazhdon të ketë vetëm një listë të përgjithshme të juristëve.

²⁷ MD, "Departamenti Ligjor", marrë nga: <http://med.rks-gov.net/Faqe.aspx?id=25&l=0>.

²⁸ Intervistë e RrGK me Drejtuesin e Departamentit, 27 Mars 2017.

²⁹ Korrespondencë e RrGK-së me udhëheqësin e Departamentit, 27 mars 2017.

³⁰ Republika e Kosovës, Zyra e Kryeministrit, Platforma e konsultimeve publike, marrë nga: <http://konsultimet.rks-gov.net/>.

³¹ Qeveria e Kosovës, Rregullorja nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, marrë nga: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Regullore_ORK_Nr._052016_per_standardet_minimale_per_procesin_e_konsultimit_public.pdf.

³² Korrespondencë e RrGK-së me udhëheqësin e Departamentit, 6 prill 2017.

Në konferencën me titull “Mundësitë e bashkëpunimit midis institucioneve të Kosovës dhe juristëve të diasporës”, e organizuar në vitin 2016, gratë përbënin 36% të pjesëmarrësve. Kjo konferencë u organizua nga Oda e Avokatëve të Kosovës dhe Ministria e Drejtësisë. Megjithatë, Departamenti nuk mbledhte dhe mirëmbante të dhëna të ndara sipas gjinisë për pjesëmarrësit në konferenca të tjera të juristëve.³³ Ministria është duke organizuar edhe një konferencë ndërkombëtare lidhur me diasporën në bashkëpunim me donatorë të tjerë siç janë Banka Botërore dhe Organizata Ndërkombëtare për Migrim. Çështjet kanë të bëjnë me ndikimin e diasporës në zhvillimin ekonomik përmes aktiviteteve, programeve dhe praktikave më të mira.

Departamenti ka bashkëpunuar edhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Policinë Kufitare të Kosovës dhe Institutin “Demokraci për Zhvillim” (D4D) për të hartuar një fletëpalosje informative për diasporën, ku përfshihen: të dhëna lidhur me mënyrën e regjistrimit të diasporës në sistemin në internet; informata lidhur me dokumentet që kërkohen për të aplikuar për gjendjen civile; informacione lidhur me atë se te cilat institucione bëhet regjistrimi i vdekjeve dhe lindjeve në vendet ku jeton diaspora dhe informacione lidhur me pikat kufitare. Kjo fletëpalosje përditësohet çdo vit dhe shpërndahet në pikat kufitare, në aeroport dhe në çadrat e regjistrimit të diasporës. Sipas udhëheqësit të Departamentit, barazia gjinore është diskutuar me anëtarët e grupit të punës që ka hartuar fletëpalosjen. Megjithatë, në fletëpalosje nuk përfshihej perspektiva gjinore.

Objektivat e rekomanduara

1. Të përmirësohet shkalla në të cilën çështjet gjinore integrohen në politikat dhe ligjet e reja.
2. Të përmirësohet mbledhja, mirëmbajtja dhe përdorimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë për të ofruar informacione më të mira për planifikimin e shpenzimeve për konferenca prej të cilave do të përfitonin si gratë, ashtu edhe burrat.
3. Të sigurohet një perspektivë gjinore në diskutimet që kanë të bëjnë me lidhjet midis diasporës dhe zhvillimit ekonomik (duke përfshirë edhe mundësinë për “kthimin e trurit”, tërheqjen e investimeve kapitale njerëzore dhe atyre financiare). Kjo është e rëndësishme duke marrë parasysh mënyrat e ndryshme përmes të cilave gratë dhe burrat i përjetojnë dhe përfshihen në komunitetet në diasporë, se si lidhen me “shtëpinë” dhe mënyrat e ndryshme si mund të kontribuojnë gratë dhe burrat për zhvillim.
4. Të sigurohet që analiza gjinore të shërbejë si mjet informimi për krijimin dhe shpërndarjen e fletëpalosjeve dhe materialeve të tjera informative të marrëdhënieve me publikun, për të bërë të mundur që ato të mbërrijnë si të gratë, ashtu edhe te burrat.

Aktivitetet e rekomanduara

1. Të përfshihet ZBGJ-ja dhe të zhvillohen konsultime me grupe të ndryshme të të drejtave të grave në kuadrin e hartimit të ligjeve dhe politikave, për të siguruar që këto të integrohen në aspektin e barazisë gjinore.
2. Të krijohet një bazë e thjeshtë e të dhënave në Excel dhe një mostër për listën e pjesëmarrësve e cila mund të përdoret gjatë konferencave për të mbledhur të dhëna për pjesëmarrësit. Të caktohet një anëtar personeli për t’i hedhur këto të dhëna në bazën e të dhënave dhe për t’i analizuar ato me qëllim ofrimin e informatave për planifikimin e buxhetit.
3. Të ftohen ekspertët e çështjeve gjinore që kanë ekspertizë lidhur me diasporën që të marrin pjesë në panele dhe diskutime gjatë konferencave, me qëllim që të ndërmerret një qasje më përfshirëse në diskutimin e marrëdhënieve midis diasporës dhe zhvillimit.
4. Të përfshihet ZBGJ-ja dhe aktivistët e të drejtave të grave, të cilët kanë ekspertizë në këtë kuptim në shqyrtimin e fletëpalosjeve informative, me qëllim që të sugjerohet përmirësimi i perspektivës gjinore brenda tyre.

³³ Intervistë e RrGK-së me udhëheqësin e Departamentit, 27 mars 2017.

Departamenti për Qendrat Kulturore në Diasporë

Departamenti për Qendrat Kulturore në Diasporë përbëhet nga Divizioni për Themelimin dhe Mbikëqyrjen e Qendrave Kulturore në Diasporë (në Turqi, Zvicër dhe Suedi) dhe Divizioni për Hartimin dhe Përditësimin e Regjistrit për Diasporën dhe Mërgatën.³⁴ Departamenti dhe divizionet janë përgjegjëse për përgatitjen e dokumentave të nevojshme për krijimin e qendrave kulturore, me vendim të Qeverisë për vendet me interes për krijimin e tyre. Departamenti është përgjegjës për hartimin e planeve të qendrave, propozimeve dhe dokumenteve dhe përditësimin e Regjistrit të Diasporës, si një projekt qeveritar. Departamenti gjithashtu promovon bashkëpunimin efikas në fushën e shkencës, teknikës, sportit ekonomisë dhe teknologjisë midis Kosovës dhe diasporës së saj dhe organizon takime me kosovarë dhe organizata drejtuese të anëtarëve të diasporës për të nxitur investimet kapitale në Kosovë. Këtu bëjnë pjesë programet dhe planet për të nxitur investimet kapitale nga diaspora. Në detyrime të tjera bëjnë pjesë: ruajtja e gjuhës shqipe dhe trashëgimisë kulturore në pajtim me legjislacionin aktual, organizimi dhe promovimi i evenimenteve kulturore, sportive dhe arsimore, dhe përkrahja e të rinjve dhe grupeve të tjera të diasporës.³⁵

Tani për tani, ka tri qendra kulturore, njëra në Turqi, njëra në Zvicër dhe tjetra në Suedi. Ato organizojnë disa aktivitete në muaj, ndërkohë që Ministria, për shkak të buxhetit të limituar mbulon shpenzimet e së paku një aktiviteti për muaj. Qeveria e Kosovës ka vendosur të financojë hapjen e qendrave shtesë kulturore,³⁶ por ato nuk janë hapur për shkak të kufizimeve buxhetore. Në të ardhmen, këto qendra do të hapen në SHBA, Gjermani, Francë dhe Austri. Shqipëria dhe Kosova kanë bashkëpunuar gjithashtu edhe në drejtim të hapjes së qendrave kulturore të përbashkët, sipas memorandumit të bashkëpunimit mes Ministrisë së Kulturës së Shqipërisë, Ministrisë së Kulturës të Kosovës dhe Ministrisë së Diasporës. Është e paqartë nëse janë zhvilluar konsultime publike përpara përzgjedhjes së këtyre vendndodhjeve apo përpara hapjes së këtyre qendrave. Në vend të kësaj, ekzistojnë spekulime sipas të cilave qeveria, me anë të një vendimi, ka bërë përzgjedhjen e këtyre vendndodhjeve, meqenëse aty jeton një përqendrim më i madh i popullatës së diasporës. Duke marrë parasysh që Regjistri i Diasporës lë të kuptohet se pjesa më e madhe e anëtarëve të diasporës jetojnë në Gjermani (36.8%)³⁷ dhe se disa pronarë biznesesh nga diaspora jetojnë në Gjermani, hapja e një qendre kulturore atje duket se është diçka praktike.³⁸ Në të njëjtën mënyrë, disa anëtarë të diasporës së regjistruar dhe pronarë biznesesh jetojnë në Zvicër (29.8%) dhe Suedi (4.6%) ku qendrat kulturore ekzistojnë prej kohësh. Ndërkohë që në Mbretërinë e Bashkuar dhe SHBA jetojnë më pak anëtarë të diasporës të regjistruar (2.4% dhe 1.97% respektivisht),³⁹ ata kanë më shumë të ngjarë të kenë bizneset e tyre (4.5% dhe 4.2% të pronarëve të bizneseve respektivisht) sesa personat që jetojnë në shtete të tjera, gjë që mund të shpjegojë pjesërisht përzgjedhjen e këtyre shteteve si vende për qendrat kulturore.

Qendrat kulturore organizojnë projekte dhe aktivitete me shoqatat e tyre anëtare dhe vullnetarët. Plani vjetor i punës për këto aktivitete dhe projekte vendoset mes departamenteve dhe divizioneve të Ministrisë. Gjatë periudhës 2015-2017, gratë përbënin 26% dhe burrat 74% të anëtarëve të 19 grupeve të punës, kryesisht sepse anëtarët janë drejtuesit e departamenteve dhe divizioneve të ministrisë, që kanë tendencë të jenë burra. Ministria nuk ka kryer analiza gjinore për të ofruar të dhëna për planifikimin e aktiviteteve të projektit. Ministria as nuk ka mbledhur dhe mirëmbajtur të dhëna të

³⁴ "Rregullorja nr. 24/2013 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistemimin e Punëve në Ministrinë e Diasporës", neni 6, marrë nga: <http://med.rks-gov.net/desk/inc/media/CAA4ABA8-C35D-42A0-8825-F2061D850FA1.pdf>.

³⁵ Ministria e Diasporës, Departamenti i Qendrave Kulturore për Diasporën, marrë nga: <http://med.rks-gov.net/Faqe.aspx?id=26&l=0>.

³⁶ Ligji nr. 04/L-095 për Diasporën dhe Mërgatën.

³⁷ Kjo përfshin 55.37% gra dhe 44.63% burra (Rezultatet preliminare të Regjistrit të Diasporës, Prishtina: 2017).

³⁸ "Rezultatet preliminare të Regjistrit të Diasporës", Prishtinë: 2017.

³⁹ Njerëzit e regjistruar dhe rezultatet e prezantuara në Rezultatet preliminare të Regjistrit të Diasporës janë prej njerëzve që kanë vizituar Kosovën në vitin 2015 dhe 2016. Procesi i regjistrimit do të vazhdojë me fazën e dytë, duke përdorur regjistrimin elektronik të anëtarëve të diasporës.

ndara sipas gjinisë lidhur me pjesëmarrësit në evenimentet e organizuara. Pa këto të dhëna dhe pa analizë gjinore, mund të rezultojë i vështirë planifikimi i aktiviteteve kulturore të cilat përmbushin nevojat e grave dhe burrave që përdorin këto qendra. Më tej, është e vështirë të dihet se sa është numri i burrave dhe grave që përfitojnë nga këto aktivitete dhe shërbime që ofrohen nga Ministria në qendrat kulturore. Këto të dhëna mund të jenë të rëndësishme për Ministrinë në kuadrin e përligjjes së shpenzimeve të ardhshme buxhetore për këto programe, duke ndihmuar në të njëjtën kohë për përmirësimin e planifikimit të përpjekjeve të punës në terren në drejtim të mirëpritjes së grupeve specifike të njerëzve që nuk përdorin qendrat dhe shërbimet e tyre. Departamenti ka shprehur vullnetin e tij që t'u kërkojë qendrave kulturore të fillojnë të dorëzojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë lidhur me pjesëmarrësit.⁴⁰

Qendrat kulturore i dërgojnë ftesat përmes medias sociale, udhëheqësve të shoqatave, postës elektronike dhe përmes telefonatave. Departamenti i monitoron këto evenimente përmes fotografive, raporteve të punës dhe pjesëmarrjes, sidomos në aktivitete me buxhet të lartë, të cilat përfshihen në raportet vjetore. Deri më sot, Departamenti nuk ka kryer monitorime ku të merret parasysh perspektiva gjinore.

Ky Departament ka qenë përgjegjës edhe për përditësimin e Regjistrit të sipërpërmendur të Diasporës dhe Mërgatës që prej vitit 2014. Në procesin e regjistrimit përfshihej regjistrimi fizik dhe elektronik i anëtarëve të diasporës. Në vitin 2016, llogaritej se 3,000 njerëz kishin aplikuar për të punuar si pjesë e këtij programi dhe vetëm 245 (52% gra dhe 48% burra) ishin përzgjedhur për të punuar për regjistrimin fizik të popullatës së diasporës për dy muaj. Gjatë përzgjedhjes së tyre u mor parasysh barazia gjinore, përkatësia minoritare dhe përfshirja e personave me aftësi të kufizuara.⁴¹ Ekziston gjithmonë mundësia që disa gra dhe burra nga diaspora të mos kenë mundësi të arrihen ose të zgjedhin të regjistroheshin si pjesë e këtij procesi, gjë që mund të çojë në informata të pasakta. Duke marrë parasysh natyra e komuniteteve të diasporës, ku njerëzit mund të mos duan që autoritetet të dinë se ku ndodhen, ku ata mund të punojnë në mënyrë të paligjshme dhe/ose ku mund të mos kenë shumë qasje shoqërore të tjerët (sidomos gratë),⁴² mundësia për shmangien e regjistrimit përbën rrezik për kuptimin drejtë të përbërjes gjinore dhe atë të moshës së diasporës.

Objektivat e rekomanduara

- I. Të përmirësohet disponueshmëria e analizës gjinore për të ofruar informata për planifikim për qendrat kulturore.

Aktivitetet e rekomanduara

- I. Të kryhet analiza gjinore lidhur me përfituesit e qendrave kulturore dhe programet e tyre, duke identifikuar se cilat janë grupet specifike të personave që mund të mos i frekuentojnë qendrat, për çfarë arsye dhe se çfarë lloje shërbimesh dhe informatash mund të ofrojnë qendrat me qëllim që prej tyre të përfitojnë anëtarë të ndryshëm të diasporës. Të merret parasysh zgjerimi i disponueshmërisë së informatave dhe shërbimeve që u ofrohen grave të reja në diasporë, me qëllim që të përfshihen të dhëna për të drejtat e tyre dhe shëndetin riprodhues, dhe mënyrën se si mund të kërkojnë ndihmë në rast se kanë nevojë.

Departamenti për Ruajtjen dhe Kultivimin e Arsimit dhe Kulturës në Diasporë

Departamenti për Ruajtjen dhe Kultivimin e Arsimit dhe Kulturës në Diasporë përbëhet nga Divizioni për Arsim Plotësues në Diasporë dhe Divizioni për Kulturën, Rininë dhe Sportet në Diasporë.

⁴⁰ Intervistë e RrGK-së me udhëheqësin e Departamentit, 27 mars 2017.

⁴¹ Në komisionet përzgjedhëse, gratë përbënin 43% të shtatë anëtarëve.

⁴² Për shembull, UNFPA-ja ka vënë në dukje mundësinë që të reja, sidomos nusët, të izoloohen në komunitetet në diasporë (Child Marriage in Kosovo (Overview) [Martesa e fëmijëve në Kosovë (vështrim i përgjithshëm)], 2014, marrë nga: <http://eeca.unfpa.org/publications/child-marriage-kosovo-overview>).

Ai është përgjegjës për krijimin e kushteve për mësimdhënien dhe nxënien e gjuhëve kombëtare në pajtim me sistemin arsimor të Republikës së Kosovës.

Departamenti bashkëpunon me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për të përkrahur zhvillimin arsimor dhe ngritjen profesionale të mësimdhënësve në Diasporë dhe ndihmon me organizimin e mësimdhënies në vende ku diaspora jeton.. Së bashku me MASHT-in, Departamenti organizon seminare trajnimi për mësimdhënësit që punojnë në diasporë dhe shpërndan libra dhe materiale të tjera arsimore; dhe organizon programe dhe projekte që ndikojnë në mbrojtjen e identitetit kulturor dhe lingistik në diasporë.

Më tej, Departamenti bashkëpunon me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe qendrat kulturore jashtë vendit për të lehtësuar projekte dhe programe. Ai koordinon dhe mbikëqyr aktivitetet kulturore, arsimore dhe sportive për diasporën.⁴³ Ndërkohë që Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm shpërndan subvencione (shih Shtojcën I, tabela I), ky Departament monitoron zbatimin e projekteve që përkrahen nga MD-ja. Ministria jep 60% deri në 80% të fondeve të projekteve përmes subvencioneve (menaxhuar nga Sekretari i Përgjithshëm) ndërkohë që pjesa tjetër bashkëfinancohet nga ana e përfituesve. Pamjaftueshmëria e personelit vë në rrezik monitorimin e duhur e projekteve të bashkëfinancuara nga Ministria, duke përfshirë edhe atë nga perspektiva gjinore, sipas udhëheqësit të Departamentit. Ky departament nuk mban të dhëna të ndara sipas gjinisë lidhur me aktivitetet e tij.

Programe dhe aktivitetet

Siç ilustron në tabelën 10, nga anëtarët e diasporës që marrin pjesë në kampet e organizuara nga Departamenti në vitin 2015, 67% ishin gra dhe 33% burra (për të dy kampet). Në vitin 2016, gratë përbënin 52% të pjesëmarrësve të “Tokës sonë”, dhe 60% të pjesëmarrësve të shkollës verore, gjë që lë të kuptohet se gratë priren të marrin pjesë në këto programe më shumë sesa burrat.

Tabela 10. Anëtarët e diasporës që marrin pjesë në kampet e organizuara nga Departamenti për Ruajtjen dhe Kultivimin e Arsimit dhe Kulturës në Diasporë, të ndarë sipas gjinisë, për periudhën 2015-2016				
Viti	Emri i kampit	# i pjesëmarrësve	# dhe % e grave	# dhe % e burrave
2015	Kampi i parë	42	30 (71%)	12 (29%)
	Kampi i dytë	52	33 (63%)	19 (37%)
2016	“Toka jonë”	31	16 (52%)	15 (48%)
	Shkollë verore	35	21 (60%)	14 (40%)

Departamenti organizon kuize edukative. Në tabelën 11 ilustron se në këtë program kanë marrë pjesë më shumë vajza (79%) sesa djem (21%) në vitin 2015 dhe

në vitin 2016 (64% krahasuar me 36%). Departamenti gjithashtu i vendos të rinjtë dhe të rejtat që vijnë nga diaspora në ministri të ndryshme të Kosovës me qëllim që të realizojnë punë praktike pa pagesë. Siç ilustron në tabelën 12, gjatë periudhës 2015-2017, praktikantët në përgjithësi ua kanë kaluar në numër praktikantëve.

Tabela 11. Nxënës të morën pjesë në kuizin në Prishtinë, të ndarë sipas gjinisë, gjatë periudhës 2015-2016			
Viti	# i pjesëmarrësve	# dhe % e vajzave	# dhe % e djemve
2015	14	11 (79%)	3 (21%)
2016	14	9 (64%)	5 (36%)

Tabela 12. Praktikantët në ministritë e Kosovës sipas gjinisë, gjatë periudhës 2015-2017			
Ministria	# i punëve praktike	# dhe % e grave	# dhe % e burrave
Ministria e Diasporës	42	27 (64%)	15 (36%)
Ministria e Financave	5	4 (80%)	1 (20%)
Ministria e Punëve të Jashtme	5	3 (60%)	2 (40%)

⁴³ Ministria e Diasporës, “Departamenti për Mbrojtjen dhe Kultivimin e Arsimit dhe Kulturës në Diasporë”, marrë nga: <http://med.rks-gov.net/Faqe.aspx?id=27&l=0>.

Ministria e Administratës Publike	1	1 (100%)	0 (0%)
Ministria e Integritetit Evropian	2	2 (100%)	0 (0%)
Ministria e Drejtësisë	5	2 (40%)	3 (60%)
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	2	2 (100%)	0 (0%)
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	4	2 (50%)	2 (50%)
Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	2	1 (50%)	1 (50%)
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	2	2 (100%)	0 (0%)
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	3	1 (33%)	2 (67%)
Ministria e Shëndetësisë	1	1 (100%)	0 (0%)
Gjithsej	74	48 (65%)	26 (35%)

Në një udhëtim të ofruar në fund të praktikës për studenta, gratë dhe burrat kanë marrë pjesë në mënyrë të barabartë në vitin 2016. Ministria nuk ka informacione lidhur me arsyet pse në programet e mësipërme kishin më shumë prirje të merrnin pjesë gratë e reja sesa burrat.

Departamenti mbështet mësimdhënien në 22 vende të ndryshme ku ndodhen anëtarët e diasporës.⁴⁴ Në seminarin e organizuar nga ana e Ministrisë për mësimdhënien nga Sllovenia, Kroacia dhe Italia, gratë përbënin 59% të 27 mësimdhënësve që morën pjesë në vitin 2016. Në seminarin e dytë të përkrahur nga Ministria në vitin 2017, gratë përbënin 58% të 45 pjesëmarrësve në Greqi. Nga mësimdhënien nga diaspora që punonin në vende të ndryshme, burrat zinin më shumë pozicione (55%) sesa gratë (44%) (tabela 13). Australia, Zelanda e re dhe Danimarka nuk kishin asnjë mësimdhënëse nga diaspora.

Tabela 13. Mësimdhënien në diasporë, sipas vendit dhe gjinisë, gjatë periudhës 2015-2017			
Vendi	# dhe % e grave	# dhe % e burrave	# i mësimdhënësve
Australia	0 (0%)	1 (100%)	1
Austria	10 (53%)	9 (47%)	19
Belgjika	13 (37%)	22 (63%)	35
Danimarka	0 (0%)	3 (100%)	3
Finlanda	7 (32%)	15 (68%)	22
Franca	1 (25%)	3 (75%)	4
Gjermania	11 (52%)	10 (48%)	21
Italia	7 (58%)	5 (42%)	12
Kroacia	10 (83%)	2 (17%)	12
ShBA	16 (50%)	16 (50%)	32
Anglia	4 (50%)	4 (50%)	8
Norvegjia	3 (20%)	12 (80%)	15
Sllovenia	7 (78%)	2 (22%)	9
Suedia	36 (43%)	47 (57%)	83
Zvicra	1 (25%)	3 (75%)	4
Zelanda e Re	0 (0%)	1 (100%)	1
Shtet i paspecifikuar	3 (38%)	5 (63%)	8
Total	129 (44%)	160 (55%)	290

Në vitin 2016, Ministria përkrahu organizimin olimpiadës sportive në Austri dhe në to morën pjesë nxënës nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia, Italia, Gjermania dhe Austria. Nga 148 pjesëmarrës, 45% ishin vajza dhe 55% djem.

Objektivat e rekomanduara

1. Të përmirësohet mbledhja dhe përdorimi i të dhënave të ndara sipas gjinisë, lidhur me përfituesit e veprimtarive, të organizuara nga ky Departament, në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore.
2. Të përmirësohet ekuilibri gjinor midis të rejave dhe të rinjve që marrin pjesë në programe.

⁴⁴ Në Zvicër, Gjermani, Suedi, Kroaci, Francë, Slloveni, Austri, Mbretëri të Bashkuar, Belgjikë, Finlandë, Norvegji, Danimarkë, Itali, Greqi, SHBA, Australi, Zelandën e Re, Republikën Çeke, dhe Ukrainë (intervistë e RrGK-së me udhëheqësin e Departamentit, 27 mars 2017).

Aktivitetet e rekomanduara

1. Të krijohet një bazë e thjeshtë e të dhënave në Excel, të ndara sipas gjinisë, me qëllim që të dokumentohet pjesëmarrja e burrave dhe grave në aktivitetet e organizuara nga ky Departament.
2. Të hartohet një strategji komunikimi për t'i reklamuar këto programe në mënyrë të tillë që të arrihen si gratë ashtu edhe burrat.

Departamenti i Hulumtimeve dhe i Përkrahjes së Investimeve të Diasporës

Departamenti i Hulumtimeve dhe i Përkrahjes së Investimeve të Diasporës përbëhet nga Divizioni për Koordinim dhe Përkrahje të Investimeve të Diasporës dhe Divizioni për Hulumtime dhe Analiza. Ai organizon një gamë veprimtarish përmes të cilave diaspora nxitet të bëjë investime kapitale në Kosovë; bashkëpunon me diasporën në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik në Kosovë; zbaton politika përmes të cilave përkrahen këto investime; dhe këshillon lidhur me politikave të zhvillimit dhe investimeve në harmoni me modelet e analizave dhe politikave të diasporës.

Për më tepër, ky Departament pasqyron praktikën e suksesshme të vendeve fqinje dhe aplikon standardet e BE-së lidhur me investimet e diasporës. Në bashkëpunim me Departamentin për Ruajtjen dhe Kultivimin e Arsimit dhe Kulturës në Diasporë, ai përgatit pasqyrat informative për vendet ku banon diaspora. Duke bashkëpunuar me këshillat lokalë, përfaqësuesit diplomatikë dhe qendrat kulturore, Departamenti realizon hulumtime në terren në vendet përkatëse, dhe i përdor rezultatet dhe rekomandimet për të ndryshuar politikën për zhvillimin e diasporës. Megjithatë, sipas udhëheqësit të Departamentit, nuk ka qenë e mundur të bëhen hulumtime për shkak të kufizimeve të buxhetit dhe mungesës së personelit.⁴⁵ Departamenti ka kryer hulumtime lidhur me praktikën më të mira në tërheqjen e investimeve nga diaspora, në bashkëpunim me Riinvest-in në vitin 2014, të titulluar “*Rrjedha e hulumtimit dhe analizës në investimin e diasporës*”.⁴⁶ Ky departament ka publikuar edhe histori suksesi të rrjeteve të biznesit që janë krijuar në vendet e reja.

